REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 80/17
Datë/Datum. 20.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: PE635-16-113-2-2-1

Sa i përket tenderit për:**"MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*
ER-LIS SHPK & VE-MOR SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Rozhajës, nr 54

(Adresa)

Peje ***30000***

(Vendi)(Kodi postar)

044111 305

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Shpetim Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkerlis@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.03.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

S.H.P.K. ER-LIS 601528211 Pejë, Vitomiricë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. 2. Identifikimi
Ankesa parashtrohet permes përfaqësuesit te OE "ER-LIS" sh.p.k.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Nr. i Prokurimit: PE635-16-113-2-2-1
Lloji i kontratës: 2 - Shërbime
Data e publikimit: 06-Dec-2016
Data e skadimit: 15-Dec-2016
Titulli i shpalljes:"MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1,Lot2 ,Lot 3
Njoftim per informata shtese dat:13.12.2016 dhe 14.12.2016
Njofim per dhenje : Leter standarde per tenderuesin e eliminuar
Kerkese per Rishqyrtim 27.12.2016
Qasje ne dokumente zyrtatre 27.12.2016
Pergjigji ne kerkesen per Rishqyrtim : 29.12.2016
VENDIMI I OSHP-së Nr 06/17 dat 16.02.2017
Njofim per dhenje : Leter standarde per tenderuesin e eliminuar dat 02.03.2017
Kerkese per qasje ne dokumente Zyrtare 06.03.2017
Kerkese per Rishqyrtim dat 07.03.2017
Pergjigje ne Kerkesen per Rishqyrtim dat: 08.03.2017, Vendimi i dates i dat: 09.03.2017

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material, lidhur lidhur me këtë aktivitet prokurimi OE ER-LIS SHPK & VE-MOR SHPK kemi bere Kerkese per rishqyrtim e cila është dorëzuar brenda afateve kohore. Dat:07.03.2017

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

ER-LIS SHPK & VE-MOR SH.P.K në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material, lidhur me këtë aktivitet prokurimi, vlerëson se Autoriteti Kontraktues, ka bërë shkeljet e dispozitave ligjore te LPP-se si dhe legjislacionit dytësor, rregullave të prokurimit si vijon:

Neni 10 i LPP-së Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 7.3 dhe 7.4 Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për prokurim-AO1
Neni 131i LPP-së Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues
Neni 69 i LPP-së, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Rr. Udh.O. - A01
Neni 24 i LPP-së,Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokuri
Neni 7 i LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
Neni 59 i LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 24,paragrafi **24.1 pika C i UPP** " Grup i Operatorëve Ekonomik "

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Rrethanat faktike:

AK, në kundërshtim me Vendimit Nr 06/ 17 dat 06.03.2017 te OSHP-se dhe dispozitave te LPP-se, ne menyre diskriminuese ka bërë Ri-Vlerësimin duke u arsytuar në konstatimet e Panelit shqyrtues:

Paneli shqyrtues, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës fakteve dhe provave të prezantuara, thënieve në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatua se lidhur me pretendimin e OE ankues se gjate qasjes në dokumente zyrtare kanë hasur në parregullsi pasi që OE-së të rekomanduar për Lot1, i ka munguar "Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së, krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik 11.1 pika C, që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit e po ashtu në kundërshtim me UO 24.1 pika C, lidhur me këtë paneli shqyrtues sqaron se konzorciumi i rekomanduar për kontratë "Doreärti & Graniti & Lindi Markings"- Pejë, në këtë aktivitet të prokurimit si dëshmi ka ofruar vetëm marrëveshjen e konzorciumit, duke premtuar se do të veprojnë si ndërmarrje e përbashkët në kryerjen e punëve, që ka qenë e nënshkruar dhe e vulosur në tre anëtarët e grupit së bashku me Deklaratat. Bazuar në dokumentet e lartpërmendura shihet se mungon deklarata e anëtarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës që të veproj në emër të grupit, e që është në kundërshtim me kërkesat në nenin 27.1 pika c tek Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për Prokurim A01.

Paneli shqyrtues, poashtu ka konstatuar se lidhur me pretendimin e OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbush dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kërkesën 1. *Listën e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, gjithashtu të bashkangjitura të jenë referencat ose procesverbalet të pranimit, në të cilen janë të përfshira edhe titujt e projekteve për Lot 1, 2, 3*, bazuar në shkresat e lëndës OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera të bashkangjitur me kontrata dhe referenca të vulosura në kopje, e jo origjinal përkitazi me kërkesën e nenit 9.2 të FDT-së. Andaj paneli shqyrtues konstaton se AK-KK Pejë nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, pasiqë ka qenë dashur që konform nenit 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shtesë.

*Vendimi i **OSHP Nr 06/17**- Paneli Shqyrtues qartë KONSTATON se:*

1. OE i rekomanduar per Lot 1, i ka munguar "Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së, krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik11.1 pika C, që është në **kundërshtim** me kërkesat e dosjes së tenderit e po ashtu në **kundërshtim** me UO 24.1 pika C.....Bazuar në dokumentet e lartëpërmendura shihet se **mungon** deklarata e anetarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqësin që të veproj në emër të grupit, e që është në kundërshtim me kërkesat në nenin 27.1 pika C tek Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për prokurim-AO1.

2. ***Paneli Shqyrtues , po ashtu ka KONSTATATUAR** se OE I rekomanduar për* kontratë **nuk i përmbush** dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kerkesen *1.* ***Lista e sherbimeve të ngjajshme e vërtetuar nga OE-origjinal**,,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO -1,2,3, bazuar në shkresen e lëndës OE I rekomanduar për kontratë si dëshmi ka ofruar listen e punëve të kryera të bashkangjitura me kontrata dhe referenca të vulosura në **KOPJE**, e **JO ORIGJINAL** përkitazi me kërkesen e nenit 9.2 të FDT-së. Andaj paneli Shqyrtues konstaton se KK Peje **nuk I ka respektuar** në tërsi dispozitat e LPP-së, pasiqë ka QEN DASHUR që konform nenit 72 të LPP-së të*

***AK Komuna e Pejes** përpiqet të sqaroj se në bazë të Vendimit të OSHP-së kan vepru konform nenit 72 të Lpp-së duke kërkuar dukumente shtese nga OE I cili sipas vendimit 06/17 ishte I pa përgjegjeshëm .*

*Pasi që, nuk na eshtë **LEJUAR QASJA** në Dokumente Zyrtare nga Autoriteti Kontraktues , nuk e kemi pas te mundur të njoftohemi se si është vepruar nga AK. Por vetë fakti I mos lejimit në Qasje vërteton dyshimin e respektimit te LPP-së*

**Nuk na mbetet asgje tjeter veq të kërkojm nga OSHP të Vërtetoj Vendimin 06/17 dhe të mer masa Ligjore ndaj AK për mos zbatimin e Vendimit 06/17 e po ashtu edhe për veprimet e marra në Kundërshtim me Legjislacionin në FUÇI sa I përket:*

1. ***Nenin 10** I LPP-së Mjetet për Promovimi I transpareces,*
2. ***Nenin 7.3 dhe 7.4** te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurim-AO1*

* **Duke mos na lejuar qasje në dokumente zyrtare, pas "RI-Vlerësimit" (Deshmia 1)**

3. ***Nenin 41**. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tender –AO1*
4. ***Neni 41.3** Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit –AO1*
5. ***Nenet 39.,39.1,39.2,39.3** Sqarimi i Tenderëve –AO1*
4. ***Neni 72.3** i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

- **Neni 39.3 sqaron se....** *lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë **vlerësimit** të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente,megjithatë, ne mënyre objektive duhet të **prezantojnë se kane ekzistuar para afatit te fundit të dorëzimit te aplikacionit** apo te **dorëzimit të tenderit**. Përveç kësaj, kërkesa nuk do te duhej qe të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.*

Është e ditur se:

OE e propozuar për Kontratë ka dështuar të përmbushë **Kërkesat e Dosjes së Tenderit (me sqarimet-informatat e AK te dates 13 dhe 14.12.2016) lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit, **dhe atë:***

1.- Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së

Krijimi i njëgrupi te operatorëve ekonomik 11.1 pika C.
Ne kundershtim me kerkesat e dosjes se tenderit e po ashtu ne kundershtim me UO 24.1,C

***2.- Lista e sherbimeve të ngjajshme e vërtetuar nga OE-origjinal**,,ku përfshihen titujt projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO -1*

** Në LISTEN e SHERBIMEVE – **JO ORIGJINAL** – e dorëzuar vetëm nga njëri anëtar i konzorciumit " Dorarti" nuk ka të specifikuar **as një kontratë të ngjajshme** – të mirembajtjes Dimërore. **(Dështmia 2)***

*3.- **Lista e pajisjeve** – mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion (në pronsi te vetën) të dështmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dështmi tjetër, të specifikuar për LOTO'n për të cilen paraqet kërkes.*

OE për Lot 1 është dashtë të posedoj dhe të dëshmoj Makinerinë :

MAKINERIT LOT-1

1	*Kamion borëpastrues*	*3copë*
2	*Makineri të leht për pastrimin e trotuareve dhe shesheve*	***1copë***
3	*Makineri të leht (Skip) për ngarkimin e borës në kamion*	***1copë***
4	*Makineri të rëndë (Ult)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirmbajtjdimëro*	

***OE** dështon të dëshmoj 3 **kamion borëpastrues** në pronësi e po ashtu dështon të dëshmoj **Makinerin e leht për pastrimin e trotuareve dhe shesheve** 1 copë.*

SQARIM:

- ***Kamion borëpastrues -*** *jan kamionët të cilët jan të paisur me thikë(pllug) për pastrimin e bores dhe hedhësen e kripës.*
- ***Makin e lehtë për pastrimin e trotuareve dhe shesheve është*** *– makineri speciale e pajisur me thikë (pllug) për pastrim dhe hedhësen e rëres + kripës.)*

- Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni Vleresues kan bërë shkelje te një-pas njëshme duke mos përfill:
- Vendimin e OSHP-së dhe Legjislacionit në fuci
- Kërkesat e Dosjes së tenderit dhe informatat shtesë (sqarimet)
- OE e propozuara pwr Kontratë dështojnë të paraqesin dokumentet e kërkuara nga AK si dhe në kundërshtim me LPP-në.
- AK dhe Komisionet Vlerësuese,mendoj që ka bërë shkelje morale dhe penale,(duke nënshkruar Deklaraten nën Betim) lidhur me nënshkrimin e vlerësimit të rrejshëm ose të gabuar në kundërshtim me Kerkesat e DT dhe të FDT-së.

PROPOZIM

OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga OE ER-LIS &VE-MOR- Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit :
Nr.PE635-16-113-2-2-1
Për tenderit : "MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNENPEJES" Lot1
Të nxjerr: **V E N D I M**

APROVOJË: si të bazuar ankesën e OE ER-LIS shpk& VE-MOR-shpk

ANULOJ: Vendimin – Njoftimi për DHENIE TE KONTRATES

URDHËROHET: AK, Komuna e Pejes këtë A e P ta kthej ne RI-Vlersim sipas LPP-së

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet e pergatitjes se dosjes se tenderit ato te sigurimit te tenderit, fitimin e humbur,humbjen e kohës, dëmtimin e imazhit të kompanisë , pergaditja e makinerise, stafit për fillimin e puneve, etj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

c) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

d) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

e)Kerkese per Rishqyrtim 25.10.2016

f) Pergjigji ne kerkesen per Rishqyrtim 29.10.2016

g) Njoftim per dhenjen e Kontrates 29.10.2016

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*